

# 1. HYRJA NË BKT SMART

Pasi të keni kryer procesin e regjistrimit, mund të hyni në BKT Smart nëpërmjet Numrit të Klientit ose Numrit Personal të kartës së identitetit dhe opsionet e tjera si mëposhtë:

## 1.1 Hyrja me Numër Klienti ose Numër Personal, Fjalëkalim dhe Fjalëkalimi me Një Përdorim (FNP)

Për të hyrë në BKT Smart duhet:

- Numri i klientit (një numër 9 shifror që jepet nga punonjësi i BKT në momentin që hapet një numër llogarie në BKT) ose numri personal i kartës suaj të identitetit
- Fjalëkalimi (i krijuar gjatë hapave të regjistrimit);
- Fjalëkalimi me një përdorim (FNP)

Sapo të klikoni ikonën e BKT Smart klikoni **HYR** për të kaluar në hapin pasardhës:

1. Klikoni këtu për të vendosur Numrin e klientit ose numrin personal

2. Vendosni fjalëkalimin



3. Klikoni butonin "HYR" për të kaluar në hapat e tjera verifikuese

Klikoni këtu për të hyrë në rast se keni harruar fjalëkalimin

4. Vendosni këtu kodin FNP dërguar me SMS në numrin tuaj të telefonit të regjistruar në sistemin e BKT

## 1.2 Hyrje në BKT SMART pa pasur nevojë për të vendosur Numrin e Klientit ose Numrin Personal



Klikoni butonin "Më Kujto" për të ruajtur "Numrin e Klientit" ose "Numrin Personal". Në çdo hyrje të mëvonshme nuk është e nevojshme të rivendosni Numrin e Klientit ose Numrin Personal.




### 1.3 Hyrje në BKT SMART pa pasur nevojë për të vendosur fjalëkalimin

Mënyrë tjetër për të hyrë në BKT Smart, është nëpërmjet të dhënave biometrike të cilat janë regjistruar më parë në pajisjen tuaj. Të dhënat biometrike nënkuptojnë gjurmët e gishtave ose skanimin e fytyrës për aparatet celulare që i ofrojnë këto tipe identifikimi. Aktivizimi i të dhënave biometrike bëhet vetëm pasi të keni hyrë një herë në BKT Smart dhe të keni aktivizuar këtë shërbim nëpërmjet hapave të mëposhtëm:

- Pasi të jeni loguar në BKT Smart klikoni te Profili juaj (ikona në maj të faqes, majtas)
- Klikoni butonin e aktivizimit përbutonit "Identifikohu me të dhënat biometrike"




- Vendorsni fjalëkalimin tuaj dhe klikoni VERIFIKO
- Skanoni gjurmët e gishtave/ fytyrën tuaj dhe do të merrni mesazhin e konfirmimit mbi aktivizimin e këtij opsioni



Pasi të keni kaluar hapin e aktivizimit, në faqen e parë Klikoni menjëherë HYR dhe:


- Klikoni mbi "Hyr me të dhëna biometrike"
- Skanoni shenjat e gishtave/ fytyrën tuaj,
- Vendorsni FNP (fjalëkalim me një përdorim) të dërguar në numrin e telefonit që keni të regjistruar në sistemin e BKT,



## 1.4 Hyrje në BKT SMART pa pasur nevojë për të vendosur fjalëkalimin me një përdorim që vjen me SMS

Aktivizimi i Smart FNP bëhet vetëm pasi të keni hyrë një herë në BKT Smart dhe të keni aktivizuar këtë shërbim nëpërmjet hapave të mëposhtëm:

- Pasi të jeni loguar në BKT Smart klikoni te Profili juaj (ikona në maj të faqes, majtas)
- Klikoni butonin e aktivizimit përbutonit "Identifikohu duke përdorur Smart FNP" dhe do të merrni mesazhin e konfirmimit mbi aktivizimin e këtij optionsi.



Pasi të keni kaluar hapin e aktivizimit, në faqen e parë klikoni menjëherë HYR dhe:

- Klikoni mbi "Hyr me të dhëna biometrike"
- Skanoni shenjat e gishtave/ fytyrën tuaj
- Automatikisht do të validohet FNP dhe do të hyni direkt në aplikacion



## 1.5 Hyrje në BKT SMART dhe Dega Internet pa pasur nevojë për të vendosur fjalëkalimin me një përdorim që vjen me SMS

**Soft PIN** është një zgjidhje gjithpërfshirëse e identifikimit me shumë faktorë që ofron metodën e validimit të aparatit telefonik. Me aktivizimin e tij, ju regjistroni pajisjen për të njohur automatikisht fjalëkalimin (PIN-in) duke eliminuar vendosjen manuale të Fjalëkalimit me një Përdorim (FNP). Soft PIN redukton periudhën kohore të shpenzuar për procesin e identifikimit. Gjithashtu Soft PIN mund të përdoret për një logim më të thjeshtë edhe në Degën Internet.

Në menunë **"Soft PIN"** ju mund të merrni në çdo moment kodin Soft PIN ose të gjeneroni një kod të ri Soft PIN.

Aktivizimi i Soft PIN bëhet vetëm pasi të keni hyrë një herë në BKT Smart dhe të keni aktivizuar këtë shërbim nëpërmjet hapave të mëposhtëm:

- Pasi të jeni loguar në BKT Smart klikoni te Profili juaj (ikona në maj të faqes, majtas)
- Klikoni butonin e aktivizimit përbutonin "Soft PIN"



- Vendosni fjalëkalimin tuaj dhe klikoni VERIFIKO
- Vendosni Kodin PIN dhe klikoni VAZHDO
- Rivendosni Kodin PIN
- Zgjidh "Ruaje Soft PIN dhe mos ma kërko më në vijim" nëse doni që Soft PIN të njihet automatikisht
- Klikoni VAZHDO dhe do të merrni mesazhin e konfirmimit mbi aktivizimin e këtij opsioni

